



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
___. ___. 2021

Tiranë, më

VENDIM

Nr. 93, datë 17.03.2021

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

EKSTRAKT

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARES {...}

POLI I DREJTËSISË

RRUGA "ANA KOMNENA"

TIRANË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “... Gjyqtare {...} ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura dhe në dosjen penale të vëzhguar gjyqtarja kualifikon drejt dhe saktë veprën penale si dhe merr në shqyrtim parashikimet e ligjit të posaçëm për konfiskimin e pasurisë. Në 4 dosjet civile të vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Evidenton natyrën e mosmarrëveshjes dhe gjykatën kompetente. Në çdo rast vihet re citimi i dispozitave ligjore procedurale dhe materiale penale apo civile, të aplikueshme në zgjidhjen e çështje. 4 dosjet gjyqësore civile të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj mbi të drejtën e pronësisë (shih dosjen 5), mbi të drejtën administrative (shih

dosjen 2), mbi procedurën për njohjen dhe vërtetësinë e dokumenteve (shi dosjet 3 dhe 4). Përzgjedhja e vendimeve nga ana e subjektit është i tillë që referon në gjykime për vepra penale të ndryshme, në gjykime me procedurë të zakonshëm ashtu dhe atë të shkurtuar, si dhe në paraqitjen e një kërkesës të veçantë në kuadër të ligjit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, duke konfirmuar njohuritë në shumëllojshmërinë e veprave penale në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, institutet të ndryshme të pjesës së përgjithshme, si grupi i strukturuar kriminal, si formë e veçantë e bashkëpunimit, tentativën, bashkimi i procedimeve, gjykimi i shkurtuar, rregullat për caktimin e dënimit, si njohuri të ligjit të posaçëm nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (shih dokumentet 1,2 dhe 3)”.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes: Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit. Evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (civil apo penal), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Në vendimet civile, evidentohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.¹

Po kështu, edhe në vendimet penale referuar natyrës së gjykimit (gjykim penal themeli, gjykim në lidhje me kërkesat për konfiskim pasurie) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), evidentohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, duke përshkruar faktin penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara. Paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit është në çdo rast e detajuar, e qartë dhe e plotë, duke përshkruar ngjarjen gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal, rolin e të pandehurit/ve në realizimin e tij, veprimet që tregojnë bashkëpunimin midis të pandehurve apo midis tyre me persona të paidentifikuar, etj.

Në lidhje me identifikimin e natyrës së çështjes, konstatohet se gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur, duke bërë një përcaktim të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve. Në këtë kontekst, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, gjyqtarja evidenton natyrën e mosmarrëveshjes dhe gjykatën kompetente.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes për të shmangur citimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të

¹Vendimi civil nr. 41-2014-848 (1897) datë 03.06.2014; Vendimi civil nr. 494 (41-2014-1049) datë 31.03.2014; Vendimi civil nr. 276 (41-2014-543) datë 19.02.2014;

zbatueshëm material, por edhe atij procedural, të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

- Në vendimet civile (mosmarrëveshje pronësie, ndryshim akti administrativ, pavërtetësi dokumenti, njohje pronar, pjesëtim pasurie apo zgjidhje martesë), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe duke cituar dispozita të ligjeve ose akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në secilën çështje, të tilla si: ligji për sigurimet shoqërore (vendimi 2423 datë 27.11.2013), ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave (vendimi nr. 276 datë 19.02.2014), ligji për privatizimin e banesave shtetërore (vendimi nr. 968 datë 14.05.2015)

- Në vendimet penale, gjyqtarja në çdo rast referon dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me: bashkëpunimin, elementët e anës objektive dhe subjektive të bashkëpunimit, kur ai përben rrethanë cilësuese të veprës penale (vendimi 31, datë 10.03.2016, vendimi 50, datë 13.04.2016); kuptimin e tentativës dhe përgjegjësinë penale për veprat e mbetura në këtë fazë (vendimi 50, datë 13.04.2016, vendimi 125, datë 05.11.2015; format e veçanta të kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”, duke iu referuar për përcaktimin e tyre dispozitës së posaçme të Kodit Penal, së bashku me referimin e parashikimeve të Ligjit nr. 7975, datë 26.07.1995, “Për lëndët narkotike dhe barnat psikotrope”, si dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara “Kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve Psikotrope”; kriteret ligjore të individualizimit të dënimit, duke referuar parashikimet e nenit 47, 48 dhe 49 të Kodit Penal. Në çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë, gjyqtarja identifikon dispozitat e ligjit të posaçëm në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore që duhet të rezultojnë të provuara, për t’i aplikuar në konfiskimin e pasurisë, si dhe identifikon parashikimet e këtij ligji lidhur me natyrën e procedimit dhe aplikimin e masave në kuadër të procedimit pasuror (vendimi 20, datë 28.09.2016).

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, kur ka qenë e nevojshme (konkretisht, vetëm në një çështje, në vendimin nr. 494, datë 31.03.2014) në çështjet me objekt njohje pronar me parashkrim fitues, gjyqtarja evidenton mospërputhjen e nenit 170 të Kodit Civil, me atë të nenit 44, paragrafët 3 dhe 4 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurie të paluajtshme”, lidhur me të drejtën që këta paragrafë i japin organeve regjistruese të ndërhyjnë në mosregjistrimin e një vendimi gjyqësor për këtë mënyrë fitimi pronësie. Gjyqtarja arsyeton se në rastin e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi, në raport me normën tjetër.

Në raste të veçanta dhe kur ka qenë e nevojshme, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm për efekt të veprimeve procedurale edhe dispozita të Konventës së Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” (vendimi nr. 31, datë 10.03.2016). Gjithashtu, gjyqtarja ka identifikuar dispozita të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Konventa e Palermos) në lidhje me dhënien e kuptimit të “grupit të strukturuar” (vendimi nr. 31, datë 10.03.2016).

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, duke evidentuar edhe konfliktin në dukje të normave, në rastet kur ka qenë e nevojshme.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “ Vihet re se gjyqtarja {...} përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës si: i) parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues (shih dokumentin 1), parimi i barrës së provës tek i paditurit referuar ligjit të posaçëm nr. 10192/2009 (shih dokumnetin3). Madje në një rast gjyqtarja citon gjatë seancës gjyqësore parimin proceduralë të disponibilitetit në arsyetimin e vendimit të ndërmjetëm për shtimin e ndërgjyqësisë me kërkesë të paditësit (shih dosjen 5). Në funksion të zbatimit të ligjit gjyqtarja përdor referenca në : i) **jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese**: vendimi nr. 4 datë 20.02.2012 rreth qëndrimit se gjatë gjykimit të shkurtuar nuk mund të behet një cilësim më i rëndë i faktit objekt akuzës, vendimi nr. 9 datë 26.02.2016 rreth qëndrimit se elementi “vend” për mbajtjen e armës, është konsideruar si rrethane jopropocionale dhe jo e arsyeshme për diferencimin në masën e dënimit (shih dokumentin 1); ii) **jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë**; vendimi nr. 2/2003 mbi aplikimin e gjykimit të shkurtuar (shih dokumentin 1 dhe2, si dhe dosjen 1), vendimi nr. 3/2011 mbi ekzistencën e tentativës në veprimet e kryera për importimin e lendes narkotike; vendimin nr. 5, datë 30.10.2012 mbi konstatimin kryesisht të pavlefshmërisë të një veprimi juridik (shih dokumentin 3), vendimi unifikues nr. 2 të vitit 2015 mbi procesverbalin e regjistrimit audio të seancës (shih dosjen 1); **jurisprudencën e Gjykatës së Lartë** mbi legjitimitetin e paditësit për ngritjen e padisë (shih dosjen 3 dhe 4).

Gjyqtarja gjatë arsyetimit të vendimeve referon edhe në akte ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar si : Konventa e Këshillit të Europës “Për ndihmën e ndërsjellët juridike në fushën penale” dhe Konventën e Këshillit të Europës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”, (shoh dokumentin 1), Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara “Kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope” (shih dokumentat 2 dhe 3), Konventën Unike për Barnat Narkotike (shih dokumentin 2); Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Konventa e Palermos) mbi përkufizimin e termiit “grup i strukturuar” (shih dokumentin 1)”.

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

(i) *Në vendimet civile*, përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- Në përcaktimin e kushteve për ngritjen e padisë së rivendikimit, gjykata interpreton për këtë qëllim nenin 296, në lidhje edhe me nenin 305 të K.Civil, për posedimin e paligjshëm.²

- Në funksion të arsyetimit ligjor, gjykata interpreton dispozitat materiale në lidhje me legjitimitetin pasiv të ndërtuar drejt nga paditësi, në përputhje me rrethanat e fakteve dhe provave të administruara (*neni 170 i K.Civil*); në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative me qëllim fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull (*neni 168 K.Civil*). Gjyqtarja interpreton nenin 306/2-3 të K.Civil në funksion të analizës së posedimit me mirëbesim.³

- Në një rast tjetër, (zgjidhje martesë) gjyqtarja interpreton dispozitat materiale të Kodit të Familjes në lidhje me një nga pasojat e zgjidhjes së martesës, në përputhje me rrethanat e fakteve dhe provave të administruara, ndryshimi i mbiemrit (*neni 146*); lidhur me mënyrën e

² Vendimi nr. 276 datë 19.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³ Vendimi nr. 494 datë 31.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (*nenet 154, 158 dhe 161*), në lidhje me dërgimin e vendimit në zyrën e gjendjes civile, pasi të marrë formë të prerë (*neni 143*).⁴

(ii) Në vendimet penale: Në çdo rast referohen, citohen dhe analizohen në mënyrë të plotë dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, të cilat janë vlerësuar me vend për t'u marrë në analizë në mbështetje të arsyetimit të vendimit, në lidhje me:

- me ushtrimin e të drejtës penale shqiptare ndaj shtetasit shqiptar i cili ka kryer një veprë penale jashtë shtetit (*neni 6/2 dhe 10/1 K.Penal*).⁵
- grupin e strukturuar kriminal, si një nga format e veçanta të bashkëpunimit, në kuptim të nenit 28/4 të K.Penal. Kuptimi dhe analiza e këtij instituti janë dhënë në mënyrë të plotë, duke mbështetur interpretimin edhe në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Konventa e Palermos).⁶
- bashkëpunimin, elementët e anës objektive dhe subjektive të bashkëpunimit, si rrethanë cilësuese e veprës penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal. Kuptimi dhe analiza e këtij instituti janë dhënë në mënyrë të plotë, si për elementët të anës objektive, ashtu edhe të anës subjektive të veprës.
- kuptimin e tentativës dhe përgjegjësinë penale për veprat e mbetura në këtë fazë. Në analizën e institutit të tentativës, gjyqtarja interpreton nenin 22 të K.Penal në përputhje me Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3, datë 24.1.2011.⁷
- kriteret ligjore të individualizimit të dënimit, duke referuar parashikimet e neneve 47, 48, 49, 50, 53, 55 dhe 59 të Kodit Penal, duke interpretuar në mënyrë logjike dhe sistematike dispozitat penale. Në analizën e ligjit në raport me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjyqtarja ka analizuar në mënyrë të posaçme kuptimin e nenit 53 në lidhje me uljen e dënimit në minimum (*vendimi 125 datë 05.11.2015*), si dhe kushtet dhe kriteret për aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në provë, referuar nenit 59 të Kodit Penal (*vendimi 50 datë 13.04.2016*). Interpretimi ligjor është bërë duke i dhënë përgjigje edhe pretendimeve të mbrojtjes së të pandehurve për aplikimin ose jo të këtyre dispozitave.

Në çështjen me objekt konfiskimin e pasurisë, gjyqtarja interpreton dispozitat e ligjit të posaçëm në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore që duhet të rezultojnë të provuara për ta aplikuar, duke analizuar plotësimin e secilit prej kushteve më vete. Në funksion të analizës së pretendimeve të ngritura nga i padituri, gjyqtarja referohet në dispozitat civile (*neni 92/ç i K.Civil*), si edhe në vendimin Unifikues nr. 5 datë 30.10.2012, mbi konstatimin kryesisht të pavlefshmërisë së një veprimi juridik.

⁴Vendimi nr. 1378, datë 10.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁵ Vendimi nr. 31, datë 10.03.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁶ Vendimi nr. 31, datë 10.03.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁷ Vendimi nr. 50 datë 13.04.2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda; Vendimi nr. 125 datë 05.11.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda;

Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale, evidentohet se gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normave procedurale, kryesisht në lidhje me:

Në vendimet penale:

- llojin e gjykimit të aplikuar (gjykim i zakonshëm apo i shkurtuar), ku në çdo rast referohet neni 404 i K.Pr.Penale dhe jepet kuptimi i tij, si dhe kushtet për pranimin ose jo të kërkesës për procedim me këtë lloj gjykimi, duke referuar në mbështetje të interpretimit të ligjit procedural edhe qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin Unifikues nr. 3/2003;
- kompetencën lëndore të gjykatës (vendimi nr. 31, datë 10.03.2016, vendimi nr. 125, datë 05.11.2015, dhe vendimi nr. 146, datë 18.12.2015);
- marrjen dhe vlerësimin e provave, vlerën provuese të thënieve të të pandehurit në procedim të lidhur, deklaratimet e të pandehurit gjatë fazës së hetimit paraprak dhe vlerën provuese të tyre, deklaratimet e dëshmitarëve në kuadër të kundërshtimit të dëshmisë dhe vlerën provuese të tyre, etj.

Në vendimet civile:

- merr në analizë plotësimin e kushteve për ngritjen e padisë referuar nenit 32/c të K.Pr.Civile, siç është interesi i ligjshëm i paditësit dhe legjitimiteti i tij në ngritjen e padisë, duke cituar dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë⁸(vendimi nr. 333 datë 02.10.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).
- ndryshimin e objektit të padisë, në referim të nenit 185/1 të K.Pr.Civile, duke argumentuar se nuk ka ndryshuar shkaku ligjor i padisë (*causa petitionis*).⁹

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, duke referuar dhe interpretuar në disa raste, edhe aspekte të veçanta të këtij parimi të tilla si: parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, parimi i barrës së provës tek i padituri, referuar ligjit të posaçëm nr. 10192/2009, parimi procedural i disponibilitetit të palës paditëse në ndërtimin e ndërgjyqësisë.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën gjyqësore, evidentohet se gjyqtarja në shumicën e vendimeve të analizuara ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht, në lidhje me: (i) me aplikimin e procedimit me gjykim të shkurtuar është referuar dhe analizuar, së bashku me bazën ligjore procedurale, Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 29.1.2013, si dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 10.2.2012; (ii) vlerësimin e bashkëpunimit si element cilësues i veprës penale, duke referuar dhe zbatuar praktikën unifikuese të Gj.L në vendimin nr. 4, datë 15.4.2011; (iii) vlerësimin lidhur me formën e kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike” dhe mbetjen e saj në fazën e tentativës. Analizohet forma e kryerjes së veprës penale, interpretohet neni 283/a i K.Penal, ligjet e posaçme, dispozitat e akteve ndërkombëtare dhe në mbështetje të argumentit të gjykatës, referohet edhe vendimi unifikues nr. 3, datë 24.1.2011; (iv) konstatimin kryesisht të pavlefshmërisë të një veprimi juridik, është referuar vendimi unifikues nr. 5, datë 30.10.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, etj. Interpretimi i dispozitave ligjore, përveç analizës specifike të kuptimit të

⁸ Vendimi nr. 1486, datë 13.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; Vendimi nr. 1559 datë 22.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁹ Vendimi nr. 2423, datë 27.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

tyre, pasurohet me referimin dhe analizën e dispozitave të akteve ndërkombëtare që gjejnë zbatim, si dhe me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, praktikën gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencën e GJEDNJ.

KONKLUSIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Subjekt i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor me cilësi. 3 vendimet penale të themelti janë organizuar sipas një strukture ku vendimi ndahet në pjesë; i) rrethanat procedurale të rezultuara gjatë hetimit, ii) fakti penal, iii) provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor. iv) pretendimet e palëve gjatë gjykimit të zhvilluar me procedurë të shkurtuar, v) arsyetimi i gjykatës. Karakteristike është arsyetimi në paragrafë më vete mbi llojin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duke referuar në ligjin e posaçëm nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, si dhe për provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore (shih dokumentin 1 dhe 2 si dhe dosjen 1).

Pavarësisht se në vendimet përfundimtare me natyrë civile nuk përdoret një metodologji e caktuar në arsyetimin e vendimit, struktura e tyre paraqitet e qëndrueshme dhe mirëorganizuar, ndjek të njëjtën standard ku në çdo vendim pjesa e parë trajton çështjen procedurale, vijon me paraqitjen e fakteve të rezultuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, identifikon normën ligjore që zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të përcaktuar sipas provave të shqyrtuar si dhe paraqet vlerësimin e gjykatës referuar provave dhe ligjit të zbatueshëm (shih dosjen 2, 3, 4 dhe 5).....Në të gjithë dokumentat dhe dosjet e vëzhguara gjyqtarja nuk përdor rregullisht të gjitha karakteristikat e gjuhës shqipe”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruesese.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohen mungesa në zbatimin e saktë të rregullave të drejtshkrimin, pasi konstatohen gabime drejtshkrimore dhe gjyqtarja me përjashtim të një vendimi të vetëm (me nr.20, datë 28.09.2016), në asnjë prej vendimeve nuk ka përdorur shkronjat “ë” dhe “ç”.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh. në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, rezulton përdorimi i termave latinë, por duke sqaruar kuptimin e tyre paraprakisht, si shkak ligjor i padisë – *causa petitionis*, etj.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit, por ka shfaqur disa mungësi në zbatimin e saktë të rregullave të drejtshkrimin.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesataren në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Mbi mesataren” duke u pikëzuar me 12 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “3 vendimet penale të themelti janë organizuar sipas një strukture ku vendimi ndahet në pjesë; i) rrethanat procedurale të rezultuara gjatë hetimit, ii) fakti penal, iii) provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor. iv) pretendimet e palëve gjatë gjykimit të zhvilluar me procedurë të shkurtuar, v) arsyetimi i gjykatës. Karakteristike është arsyetimi në paragrafë më vete mbi llojin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duke referuar në ligjin e posaçëm nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, si dhe për provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore (shih dokumentin 1 dhe 2 si dhe dosjen 1). Pavarësisht se në vendimet përfundimtare me natyrë civile nuk përdoret një metodologji e caktuar në arsyetimin e vendimit, struktura e tyre paraqitet e qëndrueshme dhe mirëorganizuar, ndjek të njëjtën standard ku në çdo vendim pjesa e parë trajton çështjen procedurale, vijon me paraqitjen e fakteve të rezultuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, identifikon normën ligjore që zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të përcaktuar sipas provave të shqyrtuar si dhe paraqet vlerësimin e gjykatës referuar provave dhe ligjit të zbatueshëm (shih dosjen 2, 3, 4 dhe 5)...”.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të

organizuar në hartimin e vendimit, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konstatohet se vendimet civile përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile:

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave lidhur me gjykatën, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe në mënyrë të përmbledhur kërkimet përfundimtare të palëve.

Në pjesën përshkruese-arsyetuese gjejnë pasqyrim: rrethanat e fakteve të çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, parashtrimi në mënyrë të përmbledhur i pretendimeve të palëve, në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionet e saj.

Pjesa e dispozitivit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me cilësinë e vendimit, ekzekutimin e tij, të drejtën e ankimit, etj. Ndjekja e një strukture pothuajse të njëjtë në paraqitjen e vendimeve përfundimtare, e cila është karakteristikë e qëndrueshme e gjyqtarës, i bën vendimet e saj tepër të qarta dhe të kuptueshme.

Po kështu, konstatohet se vendimet penale përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale:

Pjesa hyrëse përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënave e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenet përkatëse të Kodit Penal ose ligjeve të posaçme në rastin e çështjeve me objekt specifik (ligji antimafia), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të plotë ose të përmbledhur.

Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimeve gjithashtu ndjek një strukturë të mirëpërcaktuar, e cila ndiqet pothuajse në çdo rast, të organizuar në nënndarje të titulluara sipas përmbajtjes së tyre, duke orientuar qartë lexuesin. Organizimi i pjesëve të arsyetimit të vendimit ka ndjekur të njëjtën strukturë, duke filluar me paraqitjen rrethanave procedurale të çështjes, paraqitjen e faktit penal të provuar gjatë gjykimit, përshkrimin e provave të marra gjatë gjykimit, pjesë në fund të së cilës parashtrihen edhe pretendimet e mbrojtjes së të pandehurit, analiza ligjore mbi provat dhe cilësimin juridik të veprës penale, si dhe caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, pjesë në fund të së cilës evidentohen edhe disponimet lidhur me kërkesën për disponimin mbi provat materiale dhe për përcaktimin e institucionit në të cilin do të vuajë dënimin i pandehuri.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, bashkimin e dënimeve dhe uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së tij, institucionin e vuajtjes së dënimit, disponimin e plotë për provat materiale, shpenzimet procedurale, si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë,

koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar, në funksion të qartësisë së tij për palët dhe lexuesin, si dhe të ekzekutimit të tij.

Në rastin e disponimit për kërkesën e prokurorisë për konfiskimin e pasurisë, si një lloj i veçantë procedimi dhe vendimmarrje, vendimi është sërish i organizuar sipas një strukture të qartë dhe të kuptueshme, të organizuar në nënndarje dhe paragrafë të cilët, edhe pse qëndrojnë të ndarë dhe të titulluar sipas përmbajtjes, lidhen me njëri tjetrin në mënyrë logjike. Në këtë rast dispozitivi i vendimit përmban disponimet e plota sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm nr. 10192, posaçërisht neneve 26 dhe 27 të tij që përcaktojnë elementët e vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me objektin e mosmarrëveshjes. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Ajo tregon normën ligjore që zbatohet për faktin e mosmarrëveshjes, të përcaktuar sipas provave të shqyrtuara. (shi dosjet 2,3, 4 dhe5). Nga pikëpamja formale, vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit kërkesat e

legjislacionit procedural penal apo kërkesat e legjislacionit procedural civil. Karakteristikë e gjyqtarës është përfshirja në arsyetim e vendimit përfundimtar të vendimeve të ndërmjetëm të gjykatës mbi kërkesat paraprake të palëve për veçimin e çështjes si rezultat i procedimit me gjykim të shkurtuar (shih dokumentin 1), për shpalljen e moskompetencës lëndore dhe ndarjen e çështjes për këtë shkak (shih dokumentin 2), mbi aplikimin e gjykimit të shkurtuar (shih dokumentin 1, 2 dhe dosjen 1), për ndryshimin e objektit të padisë (shih dosjen 2), për thirrjen e personave të tretë në gjykim (shih dosjen 3) dhe shtimin e ndërgjyqësisë gjatë gjykimit (shih dosjen 5). Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet rregullisht për shpenzimet procedurale apo gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Në 1 rast është vërejtur se në vendimin përfundimtar gjyqtarja ka arsyetuar mbi shkakun për të cilin shpenzimet gjyqësore i janë lënë në ngarkim paditësit megjithëse padia e tij është pranuar (shih dosjen 4)... gjithashtu, tek te 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme duke cituar bazën ligjore respektive madje edhe duke referuar edhe në jurisprudencën unifikuese (shih dosjen1)”.

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale. E parë në mënyrë më konkrete, në lidhje me sa më sipër konstatohet se:

Në vendimet civile

-Evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore (mbi institutin e martesës dhe zgjidhjen e saj) në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Konkretisht, pas interpretimit të normës relevante (neni132 i K.Familjes) në lidhje me shkaqet që çojnë drejt zgjidhjes së martesës, referuar pretendimeve të palës paditëse, gjyqtarja konkludon se grindjet e vazhdueshme dhe mungesa e harmonisë familjare kanë sjellë si pasojë humbjen e kuptimit të martesës ndërmjet bashkëshortëve, duke u konsideruar tashmë si një martesë formale, në kushtet kur ata jetojnë të ndarë, e si pasojë e saj, të konkudojë në zgjidhjen e martesës. Duke qenë se: (i) kërkimi i detyrimit ushqimor për fëmijën nuk përfshihet në pasojat me karakter subjektiv të zgjidhjes së martesës dhe që zgjidhen nga gjykata vetëm nëse bashkëshorti i kërkon ato; (ii) parimi i interesit më të lartë të fëmijës (neni 2 i K.Familjes dhe neni 3 i Konventës së Organizatës

së Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijës”), kërkon që gjykata të vendosë jo vetëm për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por edhe për kontributin e prindit tjetër në rritjen e fëmijës, referuar interpretimit të normave materiale mbi detyrimin për ushqim dhe në përputhje me rrethanat e faktit konkludon në masën e përshtatshme të këtij kontributi të prindit ndaj fëmijës së mitur (nenet 154,158 dhe 161 i K.Familjes).¹⁰

- Referuar kërkit të palës paditëse për detyrimin e të paditurve që ta njohin pronar me parashkrim fitues me titull në pasurinë objekt gjykimi, gjyqtarja ndalet në analizën e legjitimitetit pasiv dhe në mbështetje edhe të normës relevante (nenit 170 të K.Civil) ku konkludon se paditësi ka vlerësuar drejt, duke thirrur si të paditur për njohjen e pronësisë me parashkrim fitues me titull, personin nga i cili e ka blerë pronën me kontratë shitblerjeje absolutisht të pavlefshme. Në funksion të arsyetimit, gjyqtarja analizon nenin 168 të K.Civil, lidhur me kushtet që duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull, duke analizuar secilin kusht më vete.¹¹

- Analizon detyrat që gjykata duhet të zgjidhë në fazën e parë të pjesëtimit të pasurisë, në bazë të nenit 370 të K.Pr.Civile. Në funksion të arsyetimit ligjor, gjyqtarja interpreton në përputhje me rrethanat e fakteve dhe provave të administruara, dispozitat e ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” (nenet 1,2 dhe 9/1) në lidhje me origjinën e titullit të pronësisë së sendit objekt gjykimi; (neni 164 të K.Civil) lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë; (neni 330 të K. Civil) në lidhje formën e krijimit të bashkëpronësisë, nëpërmjet trashëgimisë ligjore; (neni 200 i K.Civil) në lidhje me të drejtën që ka secili nga bashkëpronarët për të kërkuar pjesëtimin e sendit.

Në vendimet penale

Duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), analiza dhe arsyetimi i gjyqtarës shtjellohet në mënyrë logjike, duke integruar interpretimin dhe analizën ligjore të elementëve të veprës penale, koncepteve dhe instituteve, të shoqëruar në çdo rast me analizën e fakteve të provuara në gjykim. Në paraqitjen e faktit penal dhe provave, evidentohet një analizë e mirëfilltë dhe e plotë e të dhënave që rezultojnë nga provat e vlerësuara në tërësi dhe në raport me njëra tjetrën, në mbështetje të konkluzionit mbi faktin e pranuar si të provuar në gjykim. Paraqitja dhe analiza e elementëve të faktit penal në lidhje me veprën penale si dhe autorësinë, si në pjesën ku fakti paraqitet në një nënndarje të veçantë, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit ligjor të gjykatës, ku ai integrohet në mënyrë të natyrshme me analizën ligjore, përbën një analizë të plotë, të gjithanshme dhe të mirëfilltë të tij, si produkt i vlerësimit të integruar dhe tërësor të provave të marra dhe të shqyrtuara gjatë gjykimit. Karakteristikë e gjyqtarës është veçimi dhe analiza më e detajuar e fakteve esenciale të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj, paraqitja e provave në lidhje me secilin fakt, duke lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë provën përkatëse, me aspektin ligjor konkret për të cilin ajo shërben, si dhe elementin që sjell secila provë në shërbim të provueshmërisë së tij, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurve, në raport me faktin penal të provuar. Në çdo rast, dispozitat e ligjit procedural penal dhe civil referohen dhe analizohen në mbështetje të vlerësimit të gjyqtarës, në

¹⁰ Vendimi nr. 1378 datë 10.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹¹ Vendimi nr. 494 datë 31.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;

raport me zbatimin e tyre, apo në mbështetje të rrethanave specifike procedurale në të cilat ato gjejnë zbatim. Interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet, ecurinë procedurale të gjyqimit, kushteve dhe kriterëve ligjore të individualizimit të dënimit, konfiskimin e pasurisë, etj

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtares”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	97

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj, si kur gjykon e vetme, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtare {...} ka qënë në intervale kohor nga 1 muaj dhe 1 ditë (shih dosejn1) deri në 9 muaj e 5 ditë (shih dosjen 2). Çështja që ka patur kohë zgjatjen më të lartë të gjykimit ka qënë çështje administrative e cila është shqyrtuar në 13 seanca (1 përgatitore dhe 12 gjyqësore), ku ka ndikuar mungesa e përfaqësuesit të palës së paditur në 3 seanca, mungesa e paditësit për shkak të një fatkeqësie familjare në 1 seancë, mospagimi i shpenzimeve të aktit të ekspertimit. Asnjë seancë nuk rezultoi të ketë dështuar për mosmenaxhimin e procesit nga ana e gjyqtarës. Çështja që ka patur kohëzgjatjen më të ulët 1 muaj dhe 1 ditë, ka qënë çështje penale themeli e gjykuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe e përfunduar në 2 seanca gjyqësore”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezultoi se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu, edhe për çështjet civile, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre. Në lidhje me kërkesat për konfiskimin e pasurisë, neni 23 i Ligjit nr.10192,

datë 3.12.2009, parashikon shqyrtimin e tyre brenda tre muajve nga data e paraqitjes së kërkesës në gjykatë dhe në çdo rast jo më vonë se një vit nga data e paraqitjes së kërkesës, në rastin e çështjeve komplekse.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes.

Konkretisht, në çështjen me nr. 20 vendimi, datë 28.09.2016, gjykimi ka zgjatur 10 muaj e 4 ditë, duke përfunduar brenda afatit ligjor maksimal 1 vjeçar, të parashikuar në nenin 23, pika 2, të Ligjit nr. 10192, sipas parashikimeve të këtij Ligji në kohën e zhvillimit të gjykimit në fjalë, duke marrë parasysh ndikimin e kompleksitetit të çështjes në kohëzgjatjen e gjykimit.

Për sa më sipër, duke iu referuar çështjes për të cilën ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, rezulton se ky afat është respektuar. Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjes së analizuar më sipër, aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuar për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.*

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Ndër 5 dosjet e vëzhguara, në vetëm 1 rast është konstatuar tejkalimi i afatit standard të gjykimit i vendosur nga KLD ndërsa në shkaqet që kanë ndikuar në tejkalimin e afatit të gjykimit rezultojnë të kenë qenë dhe seancat joproduktive të cilat janë shtyrë për shkak të sjelljes së palëve ndërgjyqëse (shih dosjen 2). Në 3 dokumentat e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja, sipas atributëve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit gjyqësor. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtarja, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën përkatëse. Nga analiza e tre dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë 5 muaj e 26 ditë (shih dokumentin 1), 5 muaj e 10 ditë (shih dokumentin 2), dhe 10 muaj e 4 ditë (shih dokumentin 3). Kohëzgjatja e gjykimit tek të 3 dokumentat e paraqitur rezulton të jetë brenda afatit standardit 12 mujor të përcaktuar nga Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve (shih dokumentat 1 dhe 2), si dhe afatin standard të parashikuar nga ligji i posaçëm nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë (shih dokumentin 3)”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur brenda standardeve minimale kohore, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD, dhe duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve rezultojnë se:

Çështje penale:

- Dosja 1 – (është caktuar me short në datë 17.11.2015 dhe ka përfunduar në datë 18.12.2015) Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 1 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 11– (është caktuar me short në datë 01.09.2015 dhe ka përfunduar në datë 05.11.2015) Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 4 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).
- Vendimi 1- (është regjistruar në datë 14.10.2015 dhe ka përfunduar në datë 10.03.2016) Gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 26 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

- Vendimi 2 -*(është regjistruar në datë 03.11.2015 dhe ka përfunduar në datë 13.04.2016)* Gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 10 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

Çështje familjare:

- Dosja 9 -*(është caktuar me short në datë 18.02.2015 dhe ka përfunduar në datë 10.07.2015)* Gjykimi ka zgjatur rreth 142 ditë ose 4 muaj e 22 ditë, tej afatit 4 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet familjare.

Çështje civile:

- Dosja 2 - *(është caktuar me short në datë 22.02.2013 dhe ka përfunduar në datë 27.11.2013)* Gjykimi ka zgjatur 9 muaj e 5 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 3 - *(është caktuar me short në datë 02.09.2014 dhe ka përfunduar në datë 03.10.2014)* Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 9 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 4 - *(është caktuar me short në datë 10.09.2014 dhe ka përfunduar në datë 22.10.2014)* Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 11 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 5 - *(është caktuar me short në datë 01.10.2013 dhe ka përfunduar në datë 19.02.2014)* Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 16 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 6 - *(është caktuar me short në datë 03.04.2014 dhe ka përfunduar në datë 03.06.2014)* Gjykimi ka zgjatur 2 muaj, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 7 - *(është caktuar me short në datë 09.07.2013 dhe ka përfunduar në datë 31.03.2014)* Gjykimi ka zgjatur 8 muaj e 22 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 8 - *(është caktuar me short në datë 09.10.2014 dhe ka përfunduar në datë 24.11.2014)* Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 15 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 10 - *(është caktuar me short në datë 05.09.2014 dhe ka përfunduar në datë 14.05.2015)* Gjykimi ka zgjatur 8 muaj e 9 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

Duke patur parasysh se çështja ka për objekt pjesëtimin e pasurisë, e cila kalon në dy faza gjykimi dhe faza e dytë e gjykimit fillon në momentin që vendimi i fazës së parë merr formë të prerë, atëherë afati i gjykimit do të llogaritet duke zbritur fazën e ndërmjetme të komunikimit të vendimit të fazës së parë. Konkretisht, afati i gjykimit do të llogaritet nga data e caktimit të çështjes me short, deri në datën e përfundimit të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë (05.09.2014–29.12.2014) dhe nga data e marrjes së vendimit formë të prerë, deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar (04.02.2015–14.05.2015). Pra, gjykimi ka zgjatur 7 muaj e 4 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

Nëse do t'i referohemi përlogaritjes së afatit të gjykimit për të gjitha çështjet për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor dhe për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, rezulton se kohëzgjatja e tyre ka qenë nga 1 muaj e 1 ditë (dosja 1) deri në 9 muaj e 5 ditë (dosja 2). Rezulton që 9 nga 13 çështjet e vëzhguara të jenë gjykuar brenda standardit minimal kohor në fuqi.

Duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve për të cilat gjykimi ka përfunduar tej standardit minimal kohor, në raport me numrin e çështjeve të analizuara (4/13) rezulton se çështjet e shqyrtuara në tejkalim të standardit minimal kohor, përbëjnë rreth 30% të tyre.

Pavarësisht mënyrës së llogaritjes, duke analizuar shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit tej standardit dhe veprimet procedurale të kryera nga gjyqtarja për të menaxhuar ecurinë e çështjeve, vlerësoj se vonesat në shqyrtim nuk kanë ndodhur për shkak të mosmarrjes së masave nga ana e gjyqtarës.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 30%, si dhe shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit sipas burimeve të vlerësimit, shkaqe të cilat nuk rezultojnë në asnjë rast të jenë përgjegjësi e gjyqtarës, por për shkaqe objektive që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, njoftimin e tyre etj., vlerësohet se ky tregues duhet të pikëzohet në një nivel më lart.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja vlerësohet në nivelin “Mbi 10 - 20%”, duke u pikëzuar me 4 pikë*

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Në 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja, sipas attributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit gjyqësor. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtarja, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në gjykatën përkatëse. Nga analiza e tre dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë 5 muaj e 26 ditë (shih dokumnetin1), 5 muaj e 10 ditë (shih dokumentin 2) dhe 10 muaj e 4 ditë (shih dokumentin 3). Kohëzgjatja e gjykimit tek 3 dokumentat e paraqitura rezulton të jetë brenda afatit standard 12 mujor të përcaktuar nga Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve (shih dokumentin 1 dhe 2) si dhe afatin standard të parashikuar nga ligji i posaçëm nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë (shih dokumentin 3)”.*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.¹²

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*13 çështjet e marra në analizë 4 janë çështje penale themeli, 8 çështje civile themeli dhe 1 çështje familjare*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 4 (katër) çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë 107 ditë ose 3 muaj e 16 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.¹³
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “familjare”, rezulton të jetë 142 ditë ose 4 muaj e 22 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë.¹⁴

¹² Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” *Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.*

¹³ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “*f. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë për krime të rënda, jo më tej se 12 muaj*”.

¹⁴ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “*d. Gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj*”.

(iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 8 (tetë) çështje në kategorinë e çështjeve “civile të përgjithshme”, rezulton të jetë 135 ditë rreth 4 muaj e 13 ditë, pra e shkurtër me standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.¹⁵

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar për shumicën e kategorive të çështjeve të analizuara.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” është “Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve”, duke e pikëzuar me 4 pikë.*

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Referuar Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “...Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në aktet shoqëruese të Formularit, është 88.5%...”.

Për periudhën e vlerësimit gjyqtarës Miliana Muça:

- Për vitin 2014, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë i janë caktuar për shqyrtim 432 çështje të reja, si dhe 98 çështje i ka mbartur nga viti 2013. Ka përfunduar 431 çështje.
- Për vitin 2015 (01.01.2015-14.07.2015), në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, i janë caktuar 194 çështje të reja, si dhe ka mbartur 77 çështje nga vitit 2014. Ka përfunduar 271 çështje gjyqësore në këtë gjykatë. Për periudhën 14.07.2015-31.12.2015, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i janë caktuar për shqyrtim 31 çështje, dhe ka përfunduar 23 çështje.

¹⁵ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm, jo më tej se 6 muaj.”

- Për vitin 2016, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda i janë caktuar për shqyrtim 130 çështje dhe ka përfunduar 133 çështje. Në vitin 2016 ka mbartur 4 çështje për vitin 2017. (sipas Raportit të analizimit të aftësive profesionale, faqe 3-4).

Ndërkohë rezulton se ka përfunduar në gjithë periudhën e vlerësimit, sipas tabelave me të dhëna statistikore të administruara në faqen 141-164 dhe 190-193 të dosjes së rivlerësimit, 794 çështje, nga të cilat 749 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe 45 çështje në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 88.5% i përcaktuar në faqen 32 të Raportit, faqja 658 e dosjes së rivlerësimit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e plotë të vlerësimit rezulton në masën 88.5%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “mbi 87-93%”, duke u pikëzuar me 6 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykatat¹⁶ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtare {...} i kushton rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Në 5 raste të vëzhguara arsyetimi i vendimit gjyqësor rezulton të jetë kryer në ditën e shpalljes së vendimit (shih dosjen 5) për 2 ditë (shih dosjen 4), për 4 ditë (shih dosjet 1 dhe 3), dhe për 9 ditë (shih dosjen 2). Në të gjitha rastet arsyetimi i vendimit është bërë brenda afateve 5 dhe 10 ditor të parashikuar nga neni 113 të K.Pr.Penale dhe 380 të K.Pr.Civile. Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore rezulton të jetë 4 ditë...”*

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 146 datë 18.12.2015, është dorëzuar në datën 22.15.2015 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 2, që i përket vendimit me nr. 2423, datë 27.11.2013 është dorëzuar më datë 06.12.2013 - (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 1486, datë 13.10.2014 është dorëzuar më datë 17.10.2014 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 1559, datë 22.10.2014 është dorëzuar më datë 24.10.2014 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 276, datë 19.02.2014 është dorëzuar më datë 20.02.2014 - (1 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

¹⁶ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nëpërmjet shkresës nr. 254 Prot., datë 12.10.2020 dhe nga Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda nëpërmjet postës elektronike në datën 11.02.2021.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë nëpërmjet shkresës nr. 254 Prot., datë 12.10.2020 dhe nga Gjykata e Shkalles së Parë Për Krime të Rënda nëpërmjet postes elektronike në datën 11.02.2021, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 08.09.2020, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 41-2014-848 (1897), datë 03.06.2014 është dorëzuar në datën 11.06.2014 - (8 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 7, që i përket vendimit me nr. 494 (41-2014-1049), datë 31.03.2014 është dorëzuar në datën 08.04.2014 - (8 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 8, që i përket vendimit me nr. 41-2014-3949 (1765), datë 24.11.2014 është dorëzuar në datën 01.12.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 9, që i përket vendimit me nr. 1378 (41-2015-2753), datë 10.07.2015 është dorëzuar në datën 19.07.2015 - (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 10, që i përket vendimit me nr. 41-2015-1888 (968), datë 14.05.2015 është dorëzuar në datën 08.05.2015 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 11, që i përket vendimit me nr. 125, datë 05.11.2015 është dorëzuar më datë 09.11.2015- (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë penale krime, për 2 dosje është 4 ditë. Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë civile themeli, për 10 dosje është 5.6 ditë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategorive të çështjeve”.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” është “më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve” duke e pikëzuar me 15 pikë.*

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Në 4 dosjet civile të vëzhguara, janë planifikuar 25 seanca nga të cilat 6 seanca ose 24 % e tyre kanë qënë joproductive. Shkak i joproduktivitetit rezulton të kenë qënë : 4 raste për mungesë të përfaqësuesit të palës ndërgjyqëse (shih dosjet 2 dhe 5), 1 rast për mungesë të paditësit për shkak të një fatkeqësie familjare (shih dosjen 2), 1 rast mospagimi i shpenzimeve të aktit të ekspertimit nga paditësi megjithë detyrën e lënë nga gjyqtarja në seanca paraardhëse (shih dosjen 2)”.

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim lidhur me numrin e seancave gjyqësore të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares:

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1 – që i përket çështjes penale, me nr. 190 regjistri, datë regjistrimi 13.11.2015, përfunduar me vendimin nr. 146, datë 18.12.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, të cila kanë rezultuar produktive. Seanca është shtyrë për shkaqe procedurale, paraqitja e pretendimeve përfundimtare me shkrim nga palët dhe në seancën e dytë është shpallur vendimi përfundimtar.
- Dosja 2 – që i përket çështjes civile, me nr. 31005-00689-41-2013 regjistri, datë regjistrimi 21.02.2013 me objekt përlllogaritje pensioni, përfunduar me vendimin nr. 2423, datë 27.11.2013

të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 12 (dymbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 5 prej tyre kanë rezultuar joproduktive, 1 rast për shkak të mosparaqitjes së paditësit, 1 rast për të kryer pagesën paditësi për aktin e ekspertimit megjithëse i ishte lënë detyrë edhe më herët nga gjykata, 3 seanca janë shtyrë për mosparaqitje të palës së paditur. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si, njohjen e palëve me provat, marrje prove me ekspert, njoftimin e ndryshimit të objektit të padisë.

➤ Dosja 3 – që i përket çështjes civile, me nr. 21281-01753-41-2014 regjistri, datë regjistrimi 02.09.2014 me objekt pavërtetësi dokumenti, përfunduar me vendimin nr.1486, datë 13.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive përse kohë ka përfunduar edhe me dhënien e vendimit përfundimtar.

➤ Dosja 4 – që i përket çështjes civile, me nr. 21281-01877-41-2014 regjistri, datë regjistrimi 10.09.2014 me objekt pavërtetësi dokumenti, përfunduar me vendimin nr.1559, datë 22.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive përse kohë ka përfunduar edhe me dhënien e vendimit përfundimtar.

➤ Dosja 5 – që i përket çështjes civile, me nr. 11115-03005-41-2013 regjistri, datë regjistrimi 01.10.2013 me objekt përlllogaritje pensioni, përfunduar me vendimin nr. 276, datë 19.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 7 (shtatë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm një seancë ka rezultuar joproduktive dhe është shtyrë me kërkesës të përfaqësuesit të palës paditëse pasi ndodhej në një gjykim tjetër jashtë qytetit të Korçës. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si, lënien kohë palës paditëse për të saktësuar legjitimitetin pasiv në gjykim për të përcaktuar personat që duhet të thërras si të paditur, lënien kohë të paditurit për të garantuar përfaqësimin ligjor për të paditurën e mitur, lënien kohë palëve për tu njohur me provat, lënien kohë palëve për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim dhe shpalljen e arsytuar të vendimit.

❖ Në çështjet e për zgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

➤ Dosja 7 – që i përket çështjes civile, me nr. 976 (21281-00764-41-2014) regjistri, datë regjistrimi 03.04.2014 me objekt pavërtetësi dokumenti, përfunduar me vendimin nr. 41-2014-848 (1897), datë 03.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, të cila kanë rezultuar produktive.

➤ Dosja 8 – që i përket çështjes civile, me nr. 2803 (21281-02170-41-2014) regjistri, datë regjistrimi 09.10.2014 me objekt pavërtetësi dokumenti, përfunduar me vendimin nr. 41-2014-34949 (1765), datë 24.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive përse kohë ka përfunduar edhe me dhënien e vendimit përfundimtar.

➤ Dosja 9 – që i përket çështjes familjare, me nr. 969 (21001-00433-51-2015) regjistri, datë regjistrimi 18.02.2015 me objekt zgjidhje martesë, përfunduar me vendimin nr. 1378 (41-2015-2753), datë 10.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, të cilat janë shtyrë të gjitha për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimi i psikologut të caktuar për marrjen e mendimit lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, lënien kohë psikologut për të përgatitur raportin psikologjik, lënien kohë palëve për arritjen e një marrëveshje në lidhje me mënyrën e ushtrimit të

përgjegjësisë prindërore, në respektim kjo të vullnetit të palëve, intervistimin e fëmijëve të mitur dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

➤ Dosja 10 – që i përket çështjes civile, me nr. 2406 (11111-01845-41-2015) regjistri, datë regjistrimi 05.09.2014 me objekt pjesëtim pasurie, përfunduar me vendimin nr. 41-2015-1888 (968), datë 14.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezultojnë që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 6 (gjashtë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka qenë joproductive, e cila është shtyrë për mosparaqitje të përfaqësuesit të palës paditëse. Të gjitha seancat e tjera gjyqësore janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimi i ekspertit të caktuar për kryerjen e aktit të ekspertimit, lënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit.

➤ Dosja 11 – që i përket çështjes penale, me nr. 158 regjistri, datë regjistrimi 31.07.2015, përfunduar me vendimin nr. 125, datë 05.11.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, rezultojnë që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 7 (shtatë) seanca gjyqësore, nga të cilat 5 (pesë) seanca kanë qenë joproductive, 2 raste për shkak të mosparaqitjes së prokurorit dhe 3 raste për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit të zgjedhur.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezultojnë se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 12 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli, civile themeli dhe familjare) varion nga 1 deri në 12 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezultojnë të jetë 4.4 seanca gjyqësore.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezultojnë se:

- Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët;
- Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimi i ndryshimit të objektit të padisë, njoftimi i ekspertit, lënia kohë ekspertit për kryerjen e aktit të ekspertimit, dhënia kohë palës për të paraqitur prova, njoftimi i psikologut të caktuar për marrjen e mendimit lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, lënia kohë psikologut për të përgatitur raportin psikologjik, lënia kohë palëve për arritjen e një marrëveshjeje në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, intervistimin e fëmijëve të mitur, njohjen e palëve me provat, dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar, shtyrja e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar etj.
- Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, kur ligji parashikon të tilla (*afati 5 ditor për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar, afati 5 ditor për shpalljen e vendimit të arsyetuar*). Në çështjet penale gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural (neni 333 dhe 342/2 të K.Pr.Penale).
- Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, konstatohet respektimi në çdo rast i afatit të arsyeshëm, më i shkurtër se 15 ditë, për caktimin e seancave në rastet kur ligji nuk ka parashikuar afat.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 12 çështjeve me palë kundërshtare të

përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.4 seanca. Pavarësisht numrit mesatar të seancave, gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pavarësisht statistikave në lidhje me numrin mesatar të seancave gjyqësore në dosjet e analizuar, meqenëse këto janë rrjedhojë e shkaqeve që nuk varen prej gjyqtarës, në kushtet kur ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie në administrimin e procesit dhe ka marrë të gjitha masat për shmangien e seancave joproductive, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Gjyqtarja Miliana Muça merr masat dhe planifikon seancat në afate normale gjykimi. Nga vëzhgimi i 27 seancave, në vetëm 2 raste planifikimi tyre është realizuar mbi 30 ditë dhe në çdo rast gjyqtarja tregon kujdes duke njoftuar palët rreth shkakut të këtij relatohet të ketë qënë planifikimi i gjykatës me gatishmërinë e gjykimi të kërkesave penale për një periudhe 1 javore (shih dosjen 5). Në rastin tjetër planifikimi i seancës është për një afat 1 muaj dhe 18 ditë, ku shkakut relatohet të ketë qënë kryerja e lejes vjetore të gjykatës në muajin gusht (shih dosjen 2). Në çështjen penale të vëzhguar planifikimi i seancës dhe zhvillimi i gjykimit është në respektim të afatit procedural penale prej 14 ditë të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale, por edhe në këtë rast gjyqtarja ka treguar kujdes në pasqyrimin e shkaqeve të moszhvillimit pa ndërprerje të gjykimit duke arsyetuar si shkaqe: gjykime të tjera të planifikuara nga kjo gjykatë, qenia e një dite festë zyrtare, qenia e një dite tjetër Konferenca e

Gjyqtarëve, qenia dy ditë e kryesuese së trupës gjyqësore në trajnim (shih dosjen 1). Në tërësi, ajo ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve nga sekretaria gjyqësore, ndërsa shtyrjet e gjykimeve për njoftimin e tyre ka ndodhur për shkaqe procedurale dhe në asnjë rast nuk ka dështuar seanca për mos njoftimin e palëve ndërgjyqëse.

Në dosjet e vëzhguara, të gjitha seancat përgatitore dhe ato gjyqësore dokumentojnë vendin e zhvillimit të gjykimit, si dhe rezultojnë të jenë regjistruara në audio, në funksion të solemnitetit dhe të transparencës së gjykimit. 8 seanca gjyqësore rezultojnë të kenë filluar me vonesa prej 12 minuta, 18 minuta, 20 minuta dhe 1 orë. Në këto katër raste gjyqtarja ka relatuar rregullisht shkakun e vonesës duke respektuar nenin 4 të vendimit nr. 238/1/b, datë 24.12.2008 të KLD-së “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”, sipas të cilit “proceset gjyqësore duhet të fillojnë në respektimi të orarit të gjykimit të komunikuar dhe afishuar në gjykatë, me përjashtim të rasteve kur ka një arsye të justifikuar. Shkaqet e vonesës rezultojnë të kenë qënë : pjesëmarrja e përfaqësuesit të paditësit në një gjykim tjetër (shih dosjen 5); vijimi i gjykimit paraardhëse tej planifikimit (shih dosjen 5); pjesëmarrje e mbrojtësit në një gjykim tjetër (shih dosjen 1) dhe pjesëmarrje të anëtares së trupës gjyqësore L.B., në procedurën e shortit të organizuar nga KLD për vlerësimin profesional ndaj saj për periudhën 2007-2009 (shih dosjen 1). Gjatë gjykimit, gjyqtarja Miliana Muça identifikon veprimet procedurale që duhet kryer dhe zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, njohjen për çdo rast me të drejtat dhe detyrimet procedurale, prezantimin e gjykatës, debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në shpalljen e vendimit. Megjithatë në një rast është konstatuar edhe mangësi në njohuritë procedurale civile, siç janë marrja e vendimit për thirrjen e personit të tretë në gjykim gjatës seancës përgatitor dhe rikonfirmim i këtij vendimi serish me vendim të ndërmjetëm në seancë gjyqësore duke mos e shtyrë seancën për të njoftuar personin e tretë pasi parashikimeve ligjore të nenit 193 të K.Pr.Civile. Në këtë rast gjyqtarja e ka konsideruar të njoftuar personin e tretë referuar vendimit të marrë në seancë përgatitore. Vendimi nuk rezulton të jetë ankimuar. Ndaj gjyqtares Miliana Muça përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezultojnë ankesa të verifikuara për shkelje formale të ligjit nga ana e saj”.

Nga çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim rezulton se të gjitha i përkasin kategorisë së çështjeve penale, civile dhe familjare me palë kundërshtare.

Gjyqtarja në të gjitha rastet i ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile dhe caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, në çdo rast, duke filluar që nga brenda ditës, deri 3 ditë pas caktimit të çështjes me short. Në çështjet penale në çdo rast është respektuar afati procedural 10 ditor i parashikuar në nenin 333/1 të Kodit të Procedurës Penale. Seancat përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, duke u mbajtur me sistemin e regjistrimit audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në çështjet civile: Seancat gjyqësore rezultojnë të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni për palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për

zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarimin të hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare, duke u dhënë kohë sipas afatit procedural të përcaktuar në nenin 302 të K.Pr.Civile; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar ose shtyrjen e seancës, për shpalljen e vendimit të arsyetuar brenda afatit procedural të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

Në çështjet penale: Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal sipas parashikimeve të neneve 405 e vijues të K.Pr.Penale (në të dyja rastet është proceduar me gjykim të shkurtuar). Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për të relatuar regjistrimin e seancës në sistemin audio, relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesë me disa minuta, por në çdo rast është shoqëruar me relatimin e shkakut që ka passjellë vonesën në çeljen e seancës. Nuk rezulton në asnjë rast që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi : Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në të 5 dosjet gjyqësore janë përfshirë rregullisht padia dhe provat e paraqitura nga paditësi në procesin civil apo kërkesa për gjykim provat përkatëse, vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës së parë përgatitore, apo kalimin e çështjes në seancë gjyqësore; aktet e njoftimit të palëve; kërkesat me shkrim të palëve dhe provat e paraqitura prej tyre; procesverbali përgatitor dhe ai gjyqësor, parashtrimet e palëve dhe vendimi gjyqësor. Në rastin e dosjes penale të vëzhguar nuk është paraqitur nga gjykata fashikulli penal ndërsa nga lisat e inventarizimit të aktet rezulton të kenë qënë i përfshirë rregullisht në dosje. Vendimet e ndërmjetëm janë fiksuar gjithnjë në procesverbal dhe janë arsyetuar rregullisht ku citohet për çdo rast dhe shkaku ligjor”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjet penale fillon me aktin e shortit, urdhrin e formimit të trupit gjykues, vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar,

diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e regjistrimit të çështjes në gjykatë, kalimin e praktikës së çështje me short, padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave përgatitore dhe gjyqësore, vendimi gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në të 5 dosjet gjyqësore

janë përfshirë rregullisht padia dhe provat e paraqitura nga paditësi në procesin civil apo kërkesa për gjykim provat përkatëse, vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës së parë përgatitore, apo kalimin e çështjes në seancë gjyqësore; aktet e njoftimit të palëve; kërkesat me shkrim të palëve dhe provat e paraqitura prej tyre; procesverbali përgatitor dhe ai gjyqësor, parashtrimet e palëve dhe vendimi gjyqësor. Në rastin e dosjes penale të vëzhguar nuk është paraqitur nga gjykata fashikulli penal ndërsa nga lisat e inventarizimit të aktet rezulton të kenë qënë i përfshirë rregullisht në dosje. Vendimet e ndërmjetëm janë fiksuar gjithnjë në procesverbal dhe janë arsyetuar rregullisht ku citohet për çdo rast dhe shkaku ligjor”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seancë përgatitore apo gjyqësore, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (padia, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtares”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	94

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “*Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “08 tetor 2013-08 tetor 2016”, për gjyqtaren Miliana Muça nuk rezultojnë të dhëna negative në këtë aspekt. Nuk ka ankesa të paraqitura dhe të verifikuara mbi etiken në punë edhe nga vazhdimi i 5 dosjeve nuk rezultojnë dështime të seancave për mungesë të gjyqtarës (shih Aftësisë Organizative të Gjyqtarit)*”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren Miliana Muça, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Gjatë periudhës së vlerësimit janë paraqitur në Inspektoratin e KLD-së 3 ankesa për gjyqtaren Miliana Muça, dy në vitin 2014 dhe një ankesë në vitin 2015. Për dy nga ankesat e paraqitura (*1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015*) është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe për një ankesë të vitit 2014, pasi është verifikuar për zvarritje gjykimi, është vendosur arkivimi, me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara.

Për periudhën e vlerësimit Tetor 2013-Tetor 2016, gjatë së cilës ka filluar dhe përfunduar verifikimi nga Inspektorati i KLD, nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuar në relacion, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Miliana Muça dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
 - Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
 - Të dhënat për masa disiplinore;
 - Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezultoni të jenë paraqitur tre ankesa, referuar dhe analizuar në treguesin më sipër, të cilat janë verifikuar nga Inspektorati i KLD. Në materialet për verifikimin e ankesave rezultoni se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se: Lidhur me kontrollin e pasurisë nën hetimin e thelluar, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën “Vetting” dhe ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhshmëri me deklaratimet periodike, si dhe të mbështetura në dokumentacionin ligjor që në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” në ILDKPKI, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016”*.¹⁷

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 234, datë 04.02.2020, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarës, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pa bazuara duke konkluduar se : *“Për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues, në konsideratë të verifikimit e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë edhe pas hetimit të Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”*.¹⁸

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultoni asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultoni se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezultoni se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezultoni asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

¹⁷ Faqe 37 e vendimit të KPK nr. 234, datë 04.02.2020.

¹⁸ Faqe 37 e vendimit të KPK nr. 234, datë 04.02.2020.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “ Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nga janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Miliana Muça. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të tjera të grupeve në nevojë, ta barazisë gjinore, të pakicës apo të të miturve. Në periudhën e rivlerësimit gjyqtarja rezulton të jetë trajtuar në vijimësi në çështje të kësaj natyre me temë “zgjerimi i aksesit për njerëzit në nevojë për realizimin e të drejtave të tyre nëpërmjet gjykatave”, “ankesë i viktimave të trafikimit në procesin penal”, “parimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe zbatimi i tij në praktikën gjyqësore”, “të drejtat e njeriut”, “trajtimi i çështjeve të aksesit në drejtësi të personave me aftësi të kufizuara”, “roli i sistemit të drejtësisë në mbrojtjen dhe promovimin e standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor”. Nuk është konstatuar përdormi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve...”

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për

Statusin zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Për këto arsye, për këtë tregues “numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës”, vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës” është “i pakonsiderueshëm”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtare Miliانا Muça komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe

etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguar, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etiken gjyqësore dhe i qartë. Nga të dhënat e regjistrave të ankesave nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa për shkelje të etikës gjyqësore apo që lidhen me komunikimin e gjykatës”.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është shumë e lartë, duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 4 dosjet e

vëzhguara nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta mbi aftësinë e gjyqtares Miliana Muça për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore (Shih dokumentet 1,2 dhe 3 si dhe dosjet 2, 3, 4 dhe 5)...”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Për shkak të funksionit që kryen, ajo i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 21 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, një prej të cilave në cilësinë e moderatores, ku dhe është certifikuar. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 34 ditë trajnim gjithsej. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtareve të shkollës së parë në gjykimin e çështjeve civile apo penale si dhe në gjykimin e çështjeve në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Këto të dhëna dokumentohen me aktet shoqëruese. Gjyqtarja ka marrë pjesë edhe në trajnimin me temë “të drejtat dhe shërbimet e viktimave të trafikimit dhe mbrojtjes së dëshmitarëve” organizuar me datë 08-09 dhjetor 2011 nga shoqëria civile me mbështetje të OPDAT Albania”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDEUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, vërtetimet me nr. 591/1 Prot., datë 20.10.2016 dhe nr. 129 Prot., datë 24.10.2017 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e moderatores dhe pjesëmarrëses.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.591/1 Prot., datë 20.10.2016 dhe nr. 129 Prot., datë 24.10.2017 të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtarja Miliana Muça është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e moderatores në 1 aktivitet trajnuese, gjithsej 1 ditë dhe në cilësinë e pjesëmarrëses në 23 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 37 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9¹⁹ të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e moderatores ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlogaritur 1 ditë pjesëmarrje si moderator e barabartë me 1.5 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja Miliana Muça, gjatë periudhës tre vjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 37.5 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 23 aktivitete të zhvilluara për 37.5 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tri vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

¹⁹Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e SH.M apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren Miliana Muça ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lektore dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren Miliana Muça ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se në treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësohet se për gjyqtaren Miliana Muça ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	97	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	382	Shkëlqyeshëm

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE

NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}

PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Mbi mesataren
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë

	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES			
	Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Mbi 10-20 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve

	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Mbi 87-93 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar. 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e 	Shumë e lartë

		<i>përzgjedhura me short).</i>	
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas 	Shumë e lartë

		fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).	
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarës	▪ Dosja e rivlerësimit.	I pa konsiderueshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë

	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit.	15-120 ditë
	b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna
	c. Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		382	
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES		Shkëlqy	